

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#109

TAKIMI/ Kosovë -Shqipëri, pajtim i institucioneve për mësimin e gjuhës shqipe në Diasporë



Më datë 20 dhe 21 maj u organizua në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë një mbledhje pune me përfaqësues dhe drejtues nga Departamenti për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë i Diasporës në këtë ministri, znj. Maliqe Hashani, z. Ymer Avdiu, znj. Barbana Sekiraqa-Dobra, znj. Burbuqe Matoshi, z. Anell Bajra, nga Qendra e Botimeve për Diasporën nga Republika e Shqipërisë znj. Mimoza Hysa, znj. Fabiola Caushaj dhe z. Dorjan Doka, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Kosovës, znj. Shqipe Gashi dhe z. Arbër Salihu. Këtë takim pune e përshëndeti dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, z. Shkëlzen Morina, i cili në fjalën e tij siguroi mbështetjen e plotë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Diasporës dhe të ministres Donika Gërvalla në hapat e ndërmarrë për zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta mes qeverisë së Shqipërisë dhe Kosovës për diasporën.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

ARSIMI/ Takimi i Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë për botimet e vitit të ri shkollor

Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë (KKAD), më 23 maj 2021 mbajti takimin e radhës me anëtarët e saj, ku e pranishme ishte edhe drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën (QBD) Mimoza Hysa.

Takimin e hapi kryetari i Këshillit, Vaxhid Sejdiu, i cili paraqiti raportet e anëtarëve, të cilët vijnë nga shtetet përkatëse ku ata veprojnë, për planin dhe programin për vitin 2021.

Në këtë takim u diskutua për pajisjen me certifikata të nxënësve në Diasporë, si dhe pajisjen me tekste mësimore për vitin shkollor 2021-2021.

Gjatë takimit anëtarët e KKAD-së ndanë edhe shqetësimet e tyre me drejtoreshën e QBD-së Mimoza Hysa. Znj. Hysa paraqiti katalogun e botimeve për vitin e ri shkollor 2021-2022 përgatitur nga QBD-ja.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë të dhënat profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë.

KONFERENCA/ QSPA pjesë e takimit "Kontekstet e reja për përdorimin e gjuhëve minoritare"



Universiteti i Zadarit, Instituti SOAS për Gjuhët në Botë, në Universitetin e Londrës, Qendra Evropiane Mercator e Kërkimit Shkencor dhe Qendra Ndërdisciplinore për Dokumentacionin Social dhe Gjuhësor (CIDLes) kanë organizuar sot konferencën ndërkombëtare gjuhësore me temë "Kontekstet e reja për përdorimin e gjuhëve minoritare".

Në këtë konferencë mori pjesë edhe studiuesi i QSPA-së, dr. Etmond Cane me kujtmesën me temë: "Mbi sfidën e standardizimit dhe situatën specifike të arbëreshëve sot". Duke marrë parasysh se faktori kryesor që favorizon humbjen e gjuhës është pamjaftueshmëria e bazës së përdorimit, studiuesi Cane propozon një koordinim të harmonizuar të një kornize trepalëshe, duke përfshirë i) arbërishten lokal në një komunitet mjaft të reduktuar dhe fragmentar, ii) të mësuarit në shkollë, ekuilibruar në mënyrë të favorshme midis arbërishtes lokale dhe shqipes standarde, dhe iii) ligjërimi në komunitet, komunikimi shoqëror në sfera dhe media të tjera.




Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen